



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:224867
Datë: 16.09.2024
Numri i dokumentit: 06165439

C.nr.4604/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtorin profesional J.N. në çështjen juridiko – kontestimore të propozueses së sigurimit Sh.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, kundër kundërshtarëve të sigurimit B.B. nga Prizreni dhe B.H. nga fshati Komuna e Suharekës duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurisë, jashtë seancës, me datë 16.09.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET i tërhequr propozimi i propozueses së sigurimit Sh.K. nga Prizreni, kundër kundërshtarëve të sigurimit B.B. nga Prizreni dhe B.H. nga fshati Komuna e Suharekës, për caktimin e masës së sigurimit.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate propozuesja e sigurimit Sh.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, ka parashtruar propozim për caktimi e masës së sigurimit kundër kundërshtarëve të sigurimit B.B. nga Prizreni dhe B.H. nga fshati Komuna e Suharekës.

Me parashtresën e datës 02.09.2024 propozuesja e sigurimit Sh.K. përmes të autorizuarit të saj, av.A.H. nga Prizreni e ka njoftuar gjykatën se propozuesja e masës së sigurimit dhe kundërshtaret e masës së sigurimit kanë arritur marrëveshje, ashtu që e tërheq propozimin për caktimin e masës së sigurimit për lëndën e lartcekur.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 261 të LPK-së, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar se propozuesja e ka tërhequr propozimin për masën e sigurimit.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPRATAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4604/2024, dt.16.09.2024**

**Gjyqtarja
Njomëza Berisha**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.